



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Arsim

10 Nr. 29/18

Datë: 15.01.2018

Bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenin 5. Pika c, të Ligjit nr. 03/L – 068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2015 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm. Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri, shpall këtë :

KONKURS

Për vendet e lira punës

- **SHFMU ” Liria”Strofc**
1 Mësimdhënës/e për lëndën Gjeografi me kohë të pacaktuar.
- **SHFMU”28 Nëntori”Vërrnicë**
1 Mësues/e klase me kohë të pacaktuar
- **SHFMU”Martirët”Reznik, (në paralelen e ndarë në Shallc)**
1 Mësues/e klase me kohë të caktuar
- **SHFMU”Andon Zako Çajupi”Vushtrri**
1 Mësues/e klase me kohë të caktuar
- **SHFMU”Lumni Surdulli”Samadrexhë**
1 Shtëpijak

Kushtet për mësimdhënës :

Për këto vende të punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjeografi

- Fakulteti i Edukimit- programi: gjeografi- edukatë qytetare
- Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore-dega e gjeografisë

Kriteret e kualifikimit për mësues/e klase.

- Fakulteti i Edukimit- programi fillor.
- Fakulteti i Mësuesisë.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim :

- Formulari i aplikimit i cili merret në zyrën e arkivit Komunal
- Diploma (Certifikata e diplomimit jo më e vjetër se gjashtë muaj) e fakultetit e fotokopjuar dhe e vërtetuar nga noteri
- Fotokopja e letërnjoftimit
- Vërtetimi i përvojës së punës
- Vërtetimi nga gjykata se nuk është nën hetime
- Certifikatat e trajnimeve

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen. Konkursi mbetet i hapur 8 ditë prej ditës së shpalljes në shtyp. Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

Intervistimi me shkrim i kandidatëve mbahet më 25.01.2018, në ora: 11:00 në sallën e Kuvendit Komunal.

Kushtet për Shtëpijak :

Kandidatët e interesuar për të konkurruar për vendin e punës, Shtëpijak duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Fotokopja e letërnjoftimit
- Ekstraktin e lindjes
- Diplomën e shkollës së mesme e vërtetuar te noteri
- Vërtetimi nga gjykata se nuk është nën hetime

Detyrat e punës për shtëpijak, do të caktohen me kontratë të punës. Aplikacionet merren në zyrën e arkivit Komunal. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet e lartë cekura. Dokumentet e pa kompletuara nuk merren në shqyrtim.

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e publikimit në shtyp. Intervistimi i kandidatëve për punëtorë shtëpijak do të mbahet me datë 01.02.2018 në ora 13:30 në sallën e Kuvendit Komunal.